



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 qershor 2014
Nr.ref.:RK652/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI22/14

Parashtrues

Lulzim Hoti

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme,
Rev. nr. 237/2013, të 5 nëntorit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Lulzim Hoti (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Prizren.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i fundit është Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 237/2013, i 5 nëntorit 2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit në një datë të pacaktuar.
3. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) vëren se parashtruesi i kërkesës në formularin e kërkesës, në mënyrë të veçantë e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 232/08, të 24 majit 2010.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës Supreme, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], parimi i supozimit të pafajësisë dhe neni 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) janë shkelur.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 6 shkurt 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 6 mars 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI22/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI22/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 10 mars 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje Gjykatës Supreme dhe Ministrisë së Drejtësisë.
9. Më 12 maj 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 5 mars 2007, Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë mori vendimin, me të cilin konstatoi se parashtruesi i kërkesës, e kishte shkelur rëndë "[...] nenin 30.1 (a), (b) të Kodit të Mirësjelljes së Nëpunësve Civil, paraparë sipas Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2003/02 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001 /36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, e në pajtim me hapin 4. pika 4.2.1, 4.2.2 të Udhëzimit Administrativ nr. MSHP/DASHC 2003/04, sipas nenit 4 pika 4.1, 4.2, 4.5 dhe 4.6 të Kodit të

Mirësjelljes të Nëpunësve Civil nr. 01/2006 dhe sipas Kodit të Disiplinë të Shërbimit Korrektues të Kosovës PSV 9.2, Standardi i parë pika 4 nen (f), (g) (h) dhe (k), dhe standardi i katërt pika 7 nën (b), (d), (f) dhe (g). Kështu, Komisioni disiplinor ia shkëputi kontratën e punës parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Bordin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, kundër këtij vendimi.

11. *Më 7 maj 2007, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të parakohshme, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ishte ankuar te Komisioni për Ankesa në Ministrinë e Drejtësisë. Pas kësaj, parashtruesi i kërkesës u ankua te Komisioni për Ankesa në Ministrinë e Drejtësisë.*
12. *Më 6 gusht 2007, Komisioni për Ankesa i Ministrisë së Drejtësisë e hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe e vërtetoi vendimin e Komisionit disiplinor të 5 marsit 2007. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër këtij vendimi te Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës.*
13. *Më 5 tetor 2007, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe e vërtetoi vendimin e Komisionit të Ankesave të Ministrisë së Drejtësisë, të 6 gushtit 2007. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës konstatoi se “Nga lënda shkresore e prezantuar shihet se procedura disiplinore është zbatuar në formën e paraparë. Zyrtarët e personelit duke vepruar në bazë të paraqitjes të shkeljes disiplinore dhe kërkesës për inicimin e procedurës disiplinore, e kanë zbatuar procedurën e paraparë dhe rasti i është referuar Komisionit disiplinor. Vendimi i Komisionit disiplinor është i ligjshëm dhe i bazuar në gjendjen e plotë faktike, deklaratat e palëve dhe provat e prezantuara nga palët. Ankuesi nuk ka prezantuar dëshmi me të cilat do të dëshmonte se nuk e ka kryer shkeljen disiplinore e cila me Kodin e Disiplinës të Shërbimit Korrektues të Kosovës është përcaktuar shkelje e rëndë e disiplinës”.*
14. *Më 24 maj 2010, Gjykata Komunale në Prizren, me Aktgjykimin C. nr. 232/08, e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, me të cilën kishte kërkuar anulimin e vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës. Gjykata Komunale konstatoi se “Me shikimin dhe vlerësimin e provave të administruara të përmendura më lartë është vërtetuar se me datën 25.08.2006 është iniciuar procedura disiplinore kundër paditësit, për arsye se paditësi ka pranuar cigare dhe para nga familjarët për të burgosurin A.A.. Komisioni Disiplinor me vendimin nr.44 të dt. 05.03.2007 ka konstatuar se me këto veprime paditësi ka bërë shkelje të rëndë disiplinore [...]. Kundër këtij vendimi ka parashtruar ankesë paditësi me dt. 12.03.2007 dhe se pas kësaj Komisioni i Ankesave i Ministrisë së Drejtësisë ka marrë vendim me të cilin e ka refuzuar ankesën e paditësit dhe ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit Disiplinor. Paditësi procedurën e ka vazhduar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, si organ i fundit administrativ për të vendosur për këtë çështje dhe me dt.05.10.2007 ky organ merr vendimin nr.A 02281/2007, ku e refuzon ankesën e paditësit si të pa bazuar, duke e lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Ankesave. Andaj, nga të lartcekurat gjykata erdhi në përfundim se vendimi i të paditurit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është i ligjshëm, pasi*

është bazuar në vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, duke zbatuar në përpikëri procedurën disiplinore të paraparë me legjislacionin në fuqi për shërbyesit civil.” Pas kësaj, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut në Prizren.

15. Më 25 shtator 2012, Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktgjykimin Ac. nr. 572/2010, e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren, të 24 majit 2010. Gjykata e Qarkut konstatoi se *“Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, nuk qëndrojnë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2 të LPK-së, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as shkeljet tjera për të cilat pretendon ankesa. Gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejt ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka vendosur si në dispozitiv të aktgjyimit, e njëjta ka dhënë arsye të bazuara e në përputhje me gjendjen në shkresat e lëndës dhe provave të proceduara, arsye këto që janë të pranueshme edhe për kolegjin e kësaj gjykate”*. Përafërsisht 9 (nëntë) muaj më vonë, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër këtij aktgjykimi.
16. Më 5 nëntor 2013, Gjykata Supreme (me Aktvendimin Rev. nr. 237/2013) e hodhi poshtë si të paaftashme kërkesën për revizion. Gjykata Supreme konstatoi se *“Përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës e kishte pranuar aktgjykimin e shkallës së dytë më 8.10.2012 dhe afati për parashtrimin e kërkesës për revizion kishte filluar më 9.10.2012, kur përfaqësuesi parashtruesit të kërkesës i ishte dorëzuar aktgjykimin, dhe dita e fundit për ushtrimin e revizionit kishte qenë 7.11.2012, përderisa revizioni ishte paraqitur më 5.7.2013, d.m.th. pas afatit të lejuar [...]”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtën në punë dhe të drejtën e pafajësisë. Që të dy këto parime janë shkelur ngase e tërë procedura e udhëhequr ka qenë e drejtuar me kritere personale dhe me paragjykimin e fajit, i cili asnjëherë gjer më tani nuk është vërtetuar në ndonjë procedurë të rregulltë gjyqësore. Pra ndërprerja e marrëdhënies së punës është iniciuar dhe realizuar në saje të supozimit të një vepre penale e cila asnjëherë nuk është vërtetuar”*.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata vëren se për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh se:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

20. Për më tepër, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) c) dhe rregullin 36 (2) të Rregullores së punës, që parashohin:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...]

c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie;

[...]

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

21. Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit të kërkesës pretendon shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.
22. Megjithatë, Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të sqarojë si dhe pse janë shkelur këto të drejta kushtetuese me vendimin e kontestuar. Pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me një vendim ose përmendja e thjeshtë e neneve dhe dispozitave të Kushtetutës nuk mjaftojnë për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohet shkelja kushtetuese, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë argument bindës dhe të arsyetuar mirë në mënyrë që kërkesa të jetë e bazuar.
23. Gjykata thekson që nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet faktike apo juridike (ligjshmëria), që pretendohen të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përveç dhe deri në masën që mund të kenë cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Kështu që, kjo Gjykatë nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt. Është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe t’i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin KI14/13, parashtruese *Komuna e Podujevës* dhe Aktvendimi për papranueshmëri, i 12 marsit 2013).
24. Përveç kësaj, aktvendimet e Gjykatës Supreme dhe gjykatat e instancave të ulta kanë dhënë arsyetim në gjetjet e veta.
25. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë, për shkak të faktit se parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë në gjendje që t’i arsyetojë pretendimet e tij dhe të sigurojë dëshmi për të mbështetur pretendimet për shkelje kushtetuese me vendimin e kontestuar.

26. Prandaj, në pajtim me nenin 48 të Ligjit, dhe rregullave 36 (1) c) dhe (2) a) dhe d) të Rregullores së punës, kërkesa duhet të hidhet poshtë si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) c), 36 (2) a) dhe d) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 12 maj 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Gjyqtari raportues


Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani